

E drejta për informim

Newsletter mujor mbi mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për të Drejtën e Informimit

Newsletter është publikim i Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Fokusi i muajit

Plani i Integritetit i KDIMDP
2022 - 2025

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka miratuar Planin e Integritetit të institucionit për periudhën 2022-2025. Ky dokument u hartua në kuadër të Projektit “Forcimi i integritetit për përmirësimin e shërbimeve publike”, zbatuar nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) me mbështetjen e Ambasadës së Suedisë në Tiranë. Integriteti i institucioneve publike përbën një nga parimet më të rëndësishme të qeverisjes së mirë dhe është një nga treguesit e mirëfunksionimit të demokracisë. Zyra e Komisionerit bëhet autoriteti i parë në kategorinë e institucioneve të pavarura që ka në zbatim një Plan Integriteti.

Plani i Integritetit është i bazuar në tre shtylla kryesore: forcimin periodik të kapaciteteve profesionale dhe administrative të Zyrës së Komisionerit; modernizimin e legjislacionit parësor dhe dytësor të fushave të përgjegjësisë, si dhe realizimin e procesit të digjitalizimit të plotë të arkivës së institucionit. Ky dokument përbën qasjen e përgjithshme të autoritetit në marrëdhëniet me qytetarët, shoqërinë civile, grupet e interesit, median për akses në informacionin publik, transparencë të lartë aktive dhe proaktive, mbrojtjen e të dhënave personale, etikë, mirëadministrim të burimeve (njerëzore e financiare), pasi integriteti konsiderohet si një element kyç i shtetit të së drejtës. Për përmbushjen e plotë të parashikimeve ky dokument shoqërohet me një plan veprimi me hapa, masa dhe afate konkrete.

Planin e Integritetit e konsultoni këtu:
https://www.idp.al/wp-content/uploads/2022/09/2.-22_9_22-Plan-Integriteti-IDP-.pdf

Përmbledhje mujore
e vendimeve dhe
rekomandimeve

**VENDIM NR. 25 -
MINISTRIA E FINANCAVE
DHE EKONOMISË**

**VENDIM NR. 27 -
BASHKIA KAVAJË**

Vendimmarrja e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

TRANSPARENCA E AUTORITETEVE
PUBLIKE ËSHTË NJË NGA SHTYLLAT
E MIRËQEVERISJES

VIZITONI WWW.IDP.AL

#informim #transparencë #vendim

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, gjatë muajit shtator 2022, ka dhënë 2 vendim urdhërimi për vënien në dispozicion të informacionit në zbatim të ligjit 119/2014 "Për të drejtën e informimit" (LDI).

Me anë të vendimit nr. 27 datë 15.09.2022, Zyra e Komisionerit ka vendosur pranimin e ankesës ndaj "Bashkisë Kavajë", me objekt "Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare".

Kërkuesi ka kërkuar informacion mbi "Borxhin aktual të Autoritetit Publik; buxhetin për vitin 2020, 2021 dhe 2022; subjektet ndaj të cilave është detyrimi për shlyerjen e borxhit dhe shuma e secilit prej subjekteve; shuma e borxheve gjatë 10 viteve të fundit; masat që ka marrë Bashkia Kavajë për uljen e borxhit; problemet që i ka shkaktuar ky borxh autoritetit publik dhe nëse ekzistenca e këtij ka sjellë mungesë investimesh në këtë bashki".

Në mungesë të një përgjigje nga Autoriteti Publik, me pretendimin se është cenuar në të drejtën për informim, ankuesi ka paraqitur ankim pranë Komisionerit, duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit.

Komisioneri pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, të përcaktuara në nenin 24 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" (në vijim "LDI").

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, Komisioneri, në përputhje me nenin 10, të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", i cili parashikon: "Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur", me shkresën nr. 1487/1 prot., datë 02.09.2022, kërkoi të informohet lidhur me procedurën e ndjekur për trajtimin e kërkesës për informacion, si dhe sqarime për zotërimin e dokumentacionit të kërkuar brenda afatit të përcaktuar në shkresë.

Me kalimin e afatit të përcaktuar më sipër, Autoriteti Publik nuk ndërmoi asnjë masë për vendosjen në dispozicion të informacionit - dokumentacionit të kërkuar.

Në këto rrethana, pas konsultimit të legjisllacionit përkatës dhe dokumentacionit të administruar, Komisioneri vlerëson se informacioni - dokumentacioni

i kërkuar, përmbush kërkesat e pikës 2, të nenit 2, të LDI, sipas të cilit "Informacion publik" konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik, pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga autoriteti publik".

Në këtë kuptim, Autoriteti Publik duhet të vendosë në dispozicion të kërkuesit çdo informacion/dokumentacion, i cili është prodhuar ose mbahet nga ky i fundit në formën e zotëruar.

Në përfundim, Komisioneri thekson se, LDI ka për qëllim të nxisë përfundimisht integritetin, transparencën e të përgjegjshmërisë së Autoriteteve Publike dhe çdo subjekti tjetër jo shtetëror, që ushtron funksione publike. E drejta për informim duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre është në interesin publik.

Detyrimi për bërjen transparente të veprimtarisë së tyre, njërive të qeverisjes vendore i'u lind gjithashtu edhe në zbatim të Kreut VI, të ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar.

Konkretisht në nenin 15, të ligjit të sipërcituar "Transparenca e veprimtarisë së njërive të vetëqeverisjes vendore", parashikohet se: "Njësitë e vetëqeverisjes vendore garantojnë për publikun transparencën e veprimtarisë së tyre. Çdo akt i organeve të vetëqeverisjes vendore publikohet në faqen zyrtare të internetit të njësisë vendore dhe afishohet në vendet e caktuara nga njësia për njoftimet publike...".

Gjithashtu, bazuar në pikën 5, fusha 2, të Programit Model të Transparencës për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore miratuar me Urdhrin nr. 211, datë 10.9.2018 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, "Buxheti" në pikën 5, - Buxheti vjetor së bashku me dokumentacionin shoqërues të tij", një pjesë e informacionit të kërkuar përfshihet në kategorinë e informacionit që vendoset në dispozicion të publikut pa kërkesë.

Në përfundim Zyra e Komisionerit vendosi, urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të dokumentacionit sipas kërkesës për informacion. Autoriteti Publik duhet të vendosë në dispozicion të kërkuesit çdo informacion/dokument, i cili është prodhuar ose mbahet nga ky i fundit në formën e zotëruar, duke mbajtur në konsideratë parashikimin në nenin 17, të ligjit të sipërcituar.

Për më shumë informacion mund të lexoni të plotë vendimet në faqen e KDIMDP www.idp.al.

28 Shtator - Dita Ndërkombëtare e të Drejtës për Informim.

Në Ditën Ndërkombëtare të së Drejtës për Informim, më 28 shtator, Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, mikpriti një grup nxënësish dhe mësuesish të gjimnazeve të Tiranës “Ismail Qemali”, “Petro Nini Luarasi”, “Sami Frashëri”, “Qemal Stafa” dhe “Partizani”.

Aktiviteti kishte për qëllim njohjen e fushës së qasjes në informacionin publik që prodhojnë/administrojnë institucionet dhe kultivimin e kulturës së ndërgjegjësimit të ushtrimit në praktikë të të drejtës së informimit.

Takimi shërbeu si një vizitë informuese në mjediset e Zyrës së Komisionerit për t'u njohur me konceptet bazë të së drejtës për informim.



Të rinjtë u njohën me funksionet dhe veprimtarinë e Zyrës së Komisionerit, rolin e saj në funksion të garantimit të ushtrimit të të drejtës për të patur akses në informacionin publik, ashtu si dhe me përbushjen e detyrimeve të kuadrit rregullator nga autoritetet publike.

Në fokus ishte trajtimi i çështjeve apo problematikave të konstatuara në sektorin e arsimit, puna për forcimin e transparencës proaktive nëpërmjet përditësimit periodik të Programit të Transparencës, si dhe njohuri për rolin e koordinatorit për të drejtën e informimit. Takimi shërbeu edhe si një mundësi për zgjerimin e njohurive edhe për fushën tjetër të përgjegjësive së Zyrës së Komisionerit – mbrojtjen e të dhënave personale, ku të rinjtë morën këshilla praktike, sidomos të qasjes në rrjetet sociale.



Garantimi i të drejtës për informim, si një nga të drejtat dhe liritë themelore të qytetarit e sanksionuar në Kushtetutë (neni 23), është tregues konkret për nivelin e zhvillimit të një shoqërie demokratike. Nga ana tjetër, transparenca proaktive, përgjegjshmëria dhe integriteti i autoriteteve publike janë elemente të rëndësishme dhe me ndikim të drejtpërdrejtë në luftën kundër korrupsionit.

Bashkëpunim dhe shkëmbim eksperience me stafin e Agjencisë për Informim dhe Privatësi të Kosovës

Në kuadër të zbatimit të Marrëveshjes së Bashkëpunimit të nënshkruar gjatë muajit prill 2022, Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave mikpritni kolegë të Agjencisë për Informim dhe Privatësi të Republikës së Kosovës (AIP).

Qëllimi i këtij aktiviteti ishte shkëmbimi praktik i eksperiencave profesionale dhe administrative, si dhe zgjerimi i ndërveprimit mes stafeve të të dy autoriteteve. Në nisje të takimit Komisionerët, znj. Krenare Sogojeva-Dërmakuz dhe z. Besnik Dervishi, ndanë të njëjtin vlerësim mbi bashkëpunimin institucional, duke e cilësuar atë në të mirë dhe përfitim të qytetarëve, por edhe në funksion të zhvillimit ekonomiko-shoqëror të shteteve tona.



Në kuadër të zbatimit të Marrëveshjes së Bashkëpunimit të nënshkruar gjatë muajit prill 2022, Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave mikpritni kolegë të Agjencisë për Informim dhe Privatësi të Republikës së Kosovës (AIP).

Zyra e Komisionerit ritheksoi gjatë aktivitetit angazhimin për t'i ofruar mbështetje AIP për anëtarësimin në organizata të ndryshme evropiane apo ndërkombëtare në të dy këto fusha. Në këtë kuadër, përpjekjet e përbashkëta nuk do të ndalen, si shprehje e qasjes realiste për promovimin e të drejtave të qytetarëve, për rritjen e transparencës e llogaridhënies së autoriteteve publike dhe përgjegjshmërisë e etikës së kontrolluesve/përpunuesve publik e privat.

